

Në bazë të nenit 17 të Vendimit për punën e Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit, Këshilli për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit në seancën e mbajtur më datën 3 qershor të vitit 2021, shpall:

**KONKURS**  
**për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori”**  
**të Qytetit të Shkupit për vitin 2021**

1. Çmimi “13 Nëntori” i qytetit të Shkupit u ndahet **personave fizikë dhe juridikë** si shenjë mirënjohjeje e Qytetit të Shkupit, për **arritje**, në ekonomi, shkencë, art, kulturë, edukim dhe arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale, sport dhe kulturë fizike, kulturë teknike, mbrojtje dhe përmirësim i ambientit jetësor dhe natyrës, si dhe në segmente të tjera të jetës, punës dhe krijimit, që përbëjnë **kontribut të veçantë për zhvillimin e Qytetit dhe për përparimin e përgjithshëm dhe afirmimin** në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë.
2. Çmimi për arritje të rëndësishme në fushat e pikës së mëparshme u ndahet edhe personave fizikë dhe juridikë **nga shtete të tjera**.
3. **Studentëve dhe nxënësve** Çmimi u ndahet për punë krijuese ose arritje të suksesshme në kontinuitet në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore që përbëjnë një kontribut të veçantë për përparimin dhe afirmimin e Qytetit të Shkupit.
4. Çmimi ndahet për arritje në **periudhën e kaluar prej një viti** (llogaritur deri në përfundimin e konkursit), si dhe për një periudhë më të gjatë që përfshin **përmbylljen e një pune krijuese ose të një kontinuiteti në tërësi**.
5. Për individë, grupe krijuesish, nxënës dhe studentë Çmimi përbëhet nga **diploma dhe shumë në të holla**.
6. Çmimi për persona juridikë nga vendi dhe persona juridikë nga shtete të tjera përbëhet nga **diploma dhe pllakate**.
7. Të drejtë për propozimin e kandidatëve për Çmimin “13 Nëntori” kanë persona juridikë dhe fizikë.
8. Çmimi mund t’i ndahet përsëri fituesit të mëparshëm, por jo para afatit prej 10 viteve nga marrja e çmimit të fundit.
9. Propozimi për Çmimin duhet të arsyetohet në mënyrë të hollësishme, kurse për kandidatët individë duhet të ketë edhe biografi.

10. Bashkë me propozimin për ndarjen e Çmimit për vepra të botuara dhe botime të tjera bashkëngjiten edhe (2) ekzemplarë të veprës.

11. Konkursi zgjat deri më 10 shtator 2021.

Propozuesi duhet të japë emërtimin e plotë të tij, adresën dhe numrin e telefonit.

Formulari për konkurrimin për Çmimin “13 Nëntori”, mund të merret në zyrën pritëse të Qytetit të Shkupit ose të gjendet në ueb faqen [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).

Propozimet dorëzohen në tre kopje pranë Këshillit për ndarjen e Çmimit “13 Nëntori” të Qytetit të Shkupit (Qyteti i Shkupit – Parku i Qytetit, bul. Ilinden numër 82), Zyra pritëse.

Informacion në tel. 3297-258 dhe 3297-242.

Numër 27-5540/1  
3 qershor, 2021  
Shkup

KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMIT  
“13 NËNTORI” TË QYTETIT TË SHKUPIT